



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:132559

Datë: 01.02.2024

Numri i dokumentit: 05275208

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Durim Balaj, duke vendosur në lëndën e përmbartimore të kreditorit Gjykata Themelore Prishtinë ndaj debitorit P.M., nga Gjakova, me numër personal 1001297194 të cilin me autorizim e përfaqëson Agron Kuçi avokat nga Gjakova për shkak të pagesës së borxhit në vlerë prej 80,00 euro, jashtë seancës, më datë 01 Shkurt 2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura e përmbartimit ndaj debitorit P.M., nga Gjakova, me numër personal të cilin me autorizim e përfaqëson Agron Kuçi avokat nga Gjakova për shkak të përmbushjes së tërësishme të borxhit.

A r s y e t i m

Kreditori ka bërë propozimin për përmbartim në bazë të Aktgjykimi Penal me P.2015/19 dhe ka propozuar që gjykata të lejoj përmbartimin për shkak të shpenzimeve të procedurës dhe paushallit gjyqësor të debitorit ndaj kreditorit.

Gjykata me aktvendim CP.2019:132559 të dt.28.09.2023 e cakton dhe ka lejuar e propozimit.

Debitori me parashtrësë të datës 05.02.2024, ka informuar gjykatën se e ka përmbush 19.01.2024

Gjykata e përfundoj procedurën përmbartimore duke u bazuar në Ligjin nr.04/L-139 për procedurën përmbartimore, sepse me nenin 66 paragrafi 4 të këtij Ligji është paraparë se pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës

përmbartimore, andaj Gjykata duke e pasur për bazë këtë dispozitë ligjore vendosi si në dispozitiv.

Nga sa u tha më lartë në bazë të nenit 66, paragrafi 4 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

CP. 2019:132559 me 01 Shkurt 2024

GJYQTARI

Durim BALAJ

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë,
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh
nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes kësaj gjykate.